



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 53, datë 12.03.2021

PËR NDËRPRERJEN DHE PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS SË VERIFIKIMIT TË PASURISË DHE FIGURËS PËR PROKUROREN RITA GJATI, KANDIDATE PËR POZICIONIN E DREJTUESIT NË PROKURORITË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË KRUIJË DHE KUKËS

Bazuar në nenin 149/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 159, pika 1 dhe 2 germa "a", 184 dhe 189, pika 1, të Ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, në nenin 52, të Ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, në pikën 6, Seksioni B, të Kreut V, të Rregullores "Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin, emërimin si magjistrat dhe caktimin në pozicion të kandidatëve për prokurorë, si dhe zhvillimin e karrierës së prokurorëve", miratuar me Vendimin nr. 171, datë 27.9.2019 e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, i ndryshuar, në pikën 5, të nenit 9, të Rregullores "Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë në pozicionin e drejtuesit në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm", miratuar me Vendimin nr. 200, datë 23.09.2020, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, si dhe pasi u njoh me Relacionin "Për ndërprerjen dhe përfundimin e procedurës së verifikimit të pasurisë, figurës për prokuroren Rita Gjati, kandidate për pozicionin e drejtuesit në Prokuroritë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Krujë dhe Kukës", Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Ndërprerjen dhe përfundimin e procedurës së verifikimit të pasurisë dhe figurës për prokuroren Rita Gjati, kandidate për pozicionin e Drejtuesit në Prokuroritë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Krujë dhe Kukës, sipas tekstit bashkëlidhur.
2. Të njoftohet për këtë vendim znj. Rita Gjati.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË


**KRYETAR
GENT IBRAHIMI**

**ZV/KRYETAR
ALFRED BALLA**

**ANËTAR
KOSTAQ BELURI**



**ANËTAR
BUJAR SHESHI**



**ANËTAR
NURIHAN SEITI**



**ANËTAR
SANDËR BECI**



**ANËTAR
VATË STAKAJ**




**ANËTAR
TARTAR BAZAJ**



**ANËTAR
ESMERALDA KESHI**



**ANËTAR
ELOIDA GOXHI**



**ANËTAR
MOISI DUDA**